

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6726
E shtunë, 8 tetor 2022
çmimi 0.40

Miratohet Projektligji për Institutin e Krimeve të Kryera Gjatë Luftës

IFAQE 6



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

QYTETARËT E KOSOVËS SHPENZUAN 89 MILIONË EURO PËR PAJISJE ME VIZA SCHENGEN

IFAQE 4



Dhjetë vjet pas fillimit të dialogut për viza dhe katër vjet nga zbatimi i standardeve, Kosova është ende në pritje të një regjimi pa viza me BE-në. Ka sinjale pozitive nga BE-ja për ta përmbyllur procesin e shumëvonnar të liberalizimit për Kosovën. Javët në vijim janë vendimtare. Nga viti 2016

deri në vitin 2021 ambasadat e vendeve të Schengenit i kanë pranuar 539 344 aplikime. Duke llogaritur mesataren më të vogël të mundshme, qytetarët e Kosovës kanë paguar rreth 89 milionë euro për viza turistike për të udhëtuar drejt vendeve të BE-së

AKTUALE



OSMANI PËR ASOCIACIONIN: MBËSHITES ÇDO INICIATIVË QË S'KA KOMPETENCA EKZEKUTIVE

F. 5

KUSHTET E KËQIJA APO EMIGRIMI, ÇFARË PO I LË BIZNESET PA PUNËTORË?

F. 4

LAJÇAKU: SITUATA NË BALLKANIN PERËNDIMOR ËSHTË SHUMË MË E KEQE SE PESË VJET MË PARË

F. 6

EKONOMI



KËRROHET PROMOVIMI I PUNËS SË GRAVE NË BUJQËSI

F. 7

EVETAR ZEQIRI EMËROHET KRYESHEF EKZEKUTIV I KOSTT-it

F. 7

SPORT




PËRKRAHJA INSTITUCIONALE SHUMË E RËNDËSISHME NË ZHVILLIMIN E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS

F. 10



MËSIMDHËNË SVE GREVISTË U DALIN PAGAT E SHTATORIT

IFAQE 3



ZELENSKY: BOTA TË VEPROJË, TA NDALJË KËRCËNIMIN BËRTHAMOR RUS

IFAQE 2

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Zelensky: Bota të veprojë për ta ndalur kërcënimin bërthamor rus

KIEV, 7 TETOR - Presidenti i Ukrainës Volodymyr Zelensky tha se zyrtarët rusë kanë nisur “të përgatisin shoqërinë e tyre” për përdorimin e mundshëm të armëve bërthamore, por shtoi se ai nuk beson se Rusia është e gatshme t’i përdorë ato.

Në një intervistë për transmetuesin publik britanik BBC, Zelensky tha se nuk ka bërë thirrje për sulme në Rusi, duke pretenduar se deklaratat e mëhershme të tij janë përkthyer keq. “Duhet të përdorni goditje parandaluese”, tha ai duke iu referuar sanksioneve, “e jo sulmeve”.

Zelensky tha se bota duhet të ndër marrë veprime tani, pasi kërcënimet ruse paraqesin “rrezik për gjithë planetin”.

Në javët e fundit ushtria ukrainase ka rimarrë

kontrollin e territoreve të mëdha gjatë një kundëroffensive, që ka detyruar trupat ruse të tërhiqen nga pozicionet që i kanë mbajtur. Pas humbjeve, Rusia mbajti referendume të rreme në katër rajone ruse, dhe më pas presidenti rus, Vladimir Putin, aneksoi paligjshëm ato.

Shpallja e aneksimit nga Rusia të rajoneve ukrainase të Donjeckut, Luhanskut, Hersonit dhe Zaporizhjes, gjerësisht është dënuar nga komuniteti ndërkombëtar dhe është parë si një përshkallëzim i madh i luftës. Presidenti Putin dhe zyrtarë të tjerë rusë kanë paralajmëruar se do të përdorin të “gjitha mjetet ushtarake” për të mbrojtur këto territore, duke rritur frikën për një përdorim të mundshëm të armëve bërthamore.

Megjithatë, zyrtarët perëndimorë kanë thënë se



nuk ka të dhëna se Rusia është e gatshme të përdorë këto lloj armësh. “Ata kanë nisur ta përgatisin shoqërinë, kjo është e rrezikshme”, tha Zelensky. “Ata nuk janë të gatshëm t’i

përdorin ato, por ata kanë filluar të flasin për to. Ata nuk e dinë nëse duhet t’i përdorin apo jo. Por, unë mendoj se është e rrezikshme vetëm të flasësh për to”, shtoi Zelensky.

Rusia ka nisur pushtimin e Ukrainës më 24 shkurt, teksa shtetet perëndimore janë përgjigjur duke vendosur sanksione të ashpra ndaj Ruisë dhe duke i ofruar ndihmë ushtarake Kievit.

Liderët e BE-së, pa marrëveshje për çmimin tavan ndaj gazit rus

PRAGË, 7 TETOR - Liderët e Bashkimit Evropian janë pajtuar që të japin më shumë ndihmë financiare dhe ushtarake për Ukrainën, por ata nuk arritën ndonjë pajtim lidhur me vendosjen e një çmimi tavan për gazin gjatë samitit joformal që zhvillohet më 7 tetor në Pragë të Çekisë. Shumica e 27 shteteve të BE-së duan vendosjen e një çmimi tavan për gazin, për shkak të rritjes së çmimeve pas ndaljes së furnizimeve me gaz nga Rusia. Për këtë temë, shtetet e BE-së kanë biseduar për javë të tëra, por ka mospajtime lidhur me detajet se si duhet të bëhet kjo.

Çmimet e gazit dhe elektricitetit janë rritur shumë për shkak se Rusia ka ndërprerë furnizimet në përgjigje të sanksioneve të ashpra që BE-ja ka vendosur ndaj Moskës për shkak të luftës kundër Ukrainës.

Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, ka propozuar një “udhërrëfyes” të masave për të ndihmuar në lehtësimin e krizës, përfshirë edhe vendosjen e mundshme të një çmimi tavan.

Në mesin e ideve të përmendura janë edhe vendosja e çmimit tavan për



importet e gazit rus, uljen e çmimit të importeve të tjera të gazit, kufizimin e çmimit të gazit që përdoret për gjenerimin e rrymës dhe vendosjen e një çmimi tavan për transaksionet e gazit midis shteteve të bllokut. “Të gjithë pajtohen se ne duhet të ulim çmimin e energjisë, por nuk kemi marrëveshje se çfarë instrumente duhet të përdoren për këtë”, tha kryeministri i Polonisë, Mateusz Morawiecki. Lideri irlandez, Micheal Martin, tha po ashtu se “duhet shumë punë të bëhet” para se

të arrihet ndonjë marrëveshje. Kryeministri i Italisë, Mario Draghi, tha se Komisioni Evropian më vonë gjatë këtij muaji do t’iu prezantojë liderëve të BE-së një pako më të gjerë të masave afatshkurtra për uljen e çmimeve dhe hapa afatgjatë për të ridizajnuar tregun e rrymës.

Teksa takimi në Pragë përfundoi, Franca njoftoi se ka krijuar një fond për Ukrainën, që drejtpërdrejt të blihen armë dhe materiale të tjera nga prodhuesit e armëve. “Ne po krijojmë këtë fond të

posaçëm, që fillimisht ka 100 milionë euro, në mënyrë që të blihen armë që ne veçse kemi dërguar atje dhe ne do të vazhdojmë të veprojme kështu, të blejmë armë dhe mjete të tjera ushtarake”, tha presidenti francez, Emmanuel Macron. Ai shtoi se po zhvillohen diskutime, veçanërisht me Danimarkën, që Ukrainës t’i dërgohen topat shumë precizë CAESAR. Deri më tani, Ukraina ka pranuar 18 topa të tillë. Shefi i diplomacisë së BE-së, Josep Borrell, tha më herët gjatë 7 tetorit, se ai dëshiron

që blloku të japë më shumë para dhe mbështetje ushtarake për Ukrainën, përfshirë edhe trajnime. Borrell shtoi se propozime konkrete për këto çështje mund të miratohen më vonë gjatë tetorit.

Kancelari gjerman, Olaf Scholz, u zotua se shteti i tij do të japë një kontribut të rëndësishëm në misionin trajnues evropian.

Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky iu adresua samitit të liderëve përmes videolidhjes. Ai bëri thirrje që Evropa të ofrojë më shumë sisteme ajrore në mënyrë që të mbrohet infrastruktura energjetike ukrainase nga sulmet ruse. “Rusia e solli luftën në tokën tonë... dhe vetëm falë faktit që populli ukrainas e ndaloi këtë pushtim të Ruisë, Rusia nuk mund ta sjellë këtë luftë të njëjtë në pjesë të tjera të Evropës, veçanërisht në shtetet e Baltikut, Poloni dhe Moldavi”, tha Zelensky.

Ai bëri thirrje për presion ndërkombëtar në mënyrë që trupat ruse të tërhiqen nga centrali bërthamor i Zaporizhjes, teksa kërkoi edhe ndihmë për mbledhjen e fondeve për rindërtimin e Ukrainës.

Mësimdhënësve grevistë u dalin pagat e shtatorit

PRISHTINË, 7 TETOR - Sindikalistëve të arsimit të premtën u janë ekzekutuar pagat për muajin shtator. "Pas konfirmimit të listave nga komunat, Thesari sot ka ekzekutuar pagesën e paradhënies për orët e muajit shtator që do të zëvendësohen sipas kalendarit të ri të mësimit, të miratuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit", ka njoftuar ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati. Sindikalistët e arsimit kishin qenë në grevë nga 25 gushti

deri më 1 tetor.

Më herët gjatë javës, nga Sindikata e Arsimit, për Radion Evropë e Lirë thanë se pagat ishin ekzekutuar për shërbyesit civilë të cilët, po ashtu, ishin në grevë, por jo për punonjësit e arsimit.

Greva në sektorin publik të Kosovës u pezullua deri në janar të vitit 2023, por sindikalistët kanë thënë se nuk heqin dorë nga kërkesat e tyre. Në grevë nga 25 gushti ishin punëtorët e administratës publike në nivel lokal dhe qendror, së bashku me punëtorët e arsimit.

Sindikalistët kërkuan nga 100 euro për punëtor për çdo muaj deri në hyrjen në fuqi të Ligjit për Paga. Por, qeveria publikoi një pako për ndihmë për shkak të rritjes së inflacionit dhe në të u parapa 50 euro për të gjithë punëtorët e sektorit publik. Qeveria së fundmi ka hartuar Projektligjin për Paga dhe ai është në procedura të konsultimeve publike. Ai më pas duhet të miratohet në Qeveri dhe Kuvend, e më pas të publikohet në Gazetën Zyrtare. Tetë muaj pas publikimit në Gazetën Zyrtare, ky legjislacion pritet të hyjë në fuqi.



Hapet rruga e shpalljes së konkursit për hartimin e masterplanit për Kompleksin Memorial "Adem Jashari"



PRISHTINË, 7 TETOR - Komiteti Ndërmintor për Kompleksin Memorial "Adem Jashari" në Prekaz ka mbajtur mbledhjen e gjashtë me radhë. Anëtarët e komitetit në këtë

mbledhje miratuan hulumtimin shumësektorial për konceptin, vizionin dhe bazat e masterplanit, që ishte prezantuar në mbledhjen pararendëse. Studimi i miratuar i ishte

dorëzuar secilit anëtar për shqyrtim dhe komente eventuale. Në këtë studim përcaktohen vizioni, objektivat e përgjithshme dhe qëllimet e veçanta, duke përfshirë rezultatet e pritura,

kriteret e vlerësimit, vlerat e trashëgimisë kulturore dhe udhëzimet për hartim të masterplanit sipas attributeve të zonave të caktuara. Me këtë vendim është përmbyllur hapi i parë i një

procesi të rëndësishëm për mandatin e këtij komiteti dhe në të njëjtën kohë i është hapur rruga shpalljes së konkursit për hartimin e masterplanit për Kompleksin Memorial "Adem Jashari".

Pas dorëheqjes, Kurti takon ish-ministrin Latifi

PRISHTINË, 7 TETOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka zhvilluar një takim me Rifat Latifin, i cili dha dorëheqje nga posti i ministrit të Shëndetësisë. "Kryeministri Kurti shprehu mirënjohje për punën, angazhimin dhe kontributin e tij", u tha në njoftimin e Zyrës së Kurtit. Ndërkaq, Latifi u tha se ka shprehur gatishmërinë për vazhdimin e mbështetjes së sektorit të shëndetësisë së Kosovës.

Pas dorëheqjes së Latifit, Kurti ka emëruar zëvendësministren Dafina Gexha-Bunjaku në postin e ushtrueses së detyrës së ministres së Shëndetësisë. Latifi në detyrën e ministrit ishte emëruar në nëntor të vitit të kaluar. Ai kishte ardhur në këtë pozitë pas dorëheqjes së Arben Vitisë. Në shtator Qeveria e Kosovës ka themeluar Komisionin Ekzekutiv për Shëndetësi i cili udhëhiqet nga kryeministri

Kurti.

Sipas vendimit të qeverisë, disa nga përgjegjësitë e këtij komisioni janë zhvillimi i sistemit informativ i sistemit shëndetësor, në të gjitha nivelet e sektorit publik dhe privat, analiza dhe definimi i ndarjes dhe bashkëpunimit publiko-privat në shëndetësi si dhe reforma të tjera në sistemin shëndetësor të Kosovës.

Ky komision deri më tani ka zhvilluar disa takime.





Qytetarët e Kosovës shpenzuan 89 milionë euro për pajisje me viza Schengen

Dhjetë vjet pas fillimit të dialogut për viza dhe katër vjet nga zbatimi i standardeve, Kosova është ende në pritje të një regjimi pa viza me BE-në. Ka sinjale pozitive nga BE-ja për ta përmbyllur procesin e shumëvonuar të liberalizimit për Kosovën. Javët në vijim janë vendimtare. Nga viti 2016 deri në vitin 2021 ambasadat e vendeve të Schengenit i kanë pranuar 539 344 aplikime. Duke llogaritur mesataren më të vogël të mundshme, qytetarët e Kosovës kanë paguar rreth 89 milionë euro për viza turistike për të udhëtuar drejt vendeve të BE-së

Prishtinë, 7 tetor - Dhjetë vjet pas fillimit të dialogut për viza dhe katër vjet nga zbatimi i standardeve, Kosova është ende në pritje të një regjimi pa viza me BE-në. Ka sinjale pozitive nga BE-ja për ta përmbyllur procesin e shumëvonuar të liberalizimit

për Kosovën. Javët në vijim janë vendimtare. Me një vendim pozitiv me datën 13 tetor 2022, në takimin e Grupit Punues për Viza të Komisionit Evropian, liberalizimi i vizave për Kosovën do të hynte në rrugën formale të miratimit i cili mund të zgjasë

disa muaj. Raporti i ri i Grupit për Ballkan Regjimi i Vizave për Kosovën "a do t'i japë fund BE-ja kësaj agonie të gjatë", jep informata të detajuara për procesin dhe argumenton se vonesat nga ana e BE-së në procesin e liberalizimit janë tërësisht të pajustificueshme. Sipas këtij raporti, Kosova ka vazhduar të bëjë përparim shtesë në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, mjaftueshëm për t'i bindur shtetet anëtare skeptike.

Regjimi i vizave u ka kushtuar shumë qytetarëve dhe ekonomisë së Kosovës. Nga viti 2016 deri në vitin 2021 ambasadat e vendeve të Schengenit i kanë pranuar 539 344 aplikime. Duke llogaritur mesataren më të vogël të

mundshme, qytetarët e Kosovës kanë paguar rreth 89 milionë euro për viza turistike për të udhëtuar drejt vendeve të BE-së. Kjo shifër është jashtëzakonisht e lartë për një vend me GDP vjetore prej 4 986 dollarësh për kokë banori (2021) dhe një pagë mesatare prej 484 eurosh (2021). Megjithatë, BE-ja dhe anëtarët e saj janë donatori më i madh për Kosovën. Vlen të theksohet se Kosova do të përfitojë 63.96 milionë euro nga fondet e IPA III (2021-227).

Më tutje, regjimi i vizave ua ka pamundësuar kompanive kosovare të kenë qasje të barabartë me fqinjët e tyre në tregjet evropiane. Marrëveshja për Stabilizim Asocim me BE-në (2015) ka pasur efekte më të vogla për Kosovën sesa për vendet e tjera të rajonit, mu për

shkak të moslëvizjes së lirë të njerëzve. Nuk mund të ketë lëvizje të lirë të mallrave e shërbimeve (siç parashihet në MSA) pa lëvizje të lirë të njerëzve.

Rrjedhimisht, kompanitë e Kosovës, në krahasim me ato të rajonit, kanë qenë gjithnjë në disavantazh dhe kanë mundësi më të pakta. Kompanitë e Kosovës, të anketuara nga Grupi për Ballkanin, konsiderojnë se regjimi i vizave ka ndikuar negativisht në qarkullim me 15-50 %. Prandaj, të dhënat dhe argumentet e paraqitura në raport duhet t'i shtyjnë edhe më shumë vendet e BE-së që ta miratojnë liberalizimin e vizave për Kosovën dhe atë sa më parë që të jetë e mundur, thuhet në raportin e Grupit Kërkimor të Politikave të Ballkanit (BPRG).

Kushtet e këqija apo emigrimi, çfarë po i lë bizneset pa punëtorë?

PRISHTINË, 7 TETOR - Në dyert dhe dritaret e bizneseve në Kosovë janë bërë të shpeshta shpalljet nëpërmjet të cilave kërkohen punëtorë.

Dhjetëra biznese në kryeqytetin e Kosovës, Prishtinë, kanë të vendosura shpallje të tilla.

Shitës, punëtor arke, rrobaqepës, kuzhinier e kamerier janë profesionet që kërkohen më së shumti muajt e fundit.

Ekipi i Radios Evropa e Lirë ditët e fundit ka fotografuar dhjetëra shpallje të tilla në rrugët e kryeqytetit.

Zyrtarisht në nivel vendi, sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, papunësia kalon shifrat prej 17-përqindësh. Por, pavarësisht këtij niveli të lartë të papunësisë, bizneset po e kanë të vështirë të gjejnë punëtorë të rinj. Në konkurset e tyre pakkush paraqitet.

Bujar Hajdini është një biznesmen nga Prishtina që operon në sektorin e tekstilit.

Ai ka të punësuar rreth 30 punëtorë që kryesisht janë rrobaqepës. Aktualisht ka të hapur 20 vende të reja të punës. Përveç në rrjetet sociale, ai ka vendosur edhe shpallje fizike me shpresën se dikush do të paraqitet. "Çfarë, nuk lajmërohet askush. Para 4-5 vitesh apo më shumë nuk ndalej telefoni kurrë", tregon Hajdini përvojën që ka me shpalljen e fundit.

Hajdini thotë se mungesa e punëtorëve, sidomos atyre të kualifikuar, ia ka pamundësuar zgjerimin e biznesit. "Të kualifikuarit shumica po dalin [jashtë vendit] edhe pse pagat nuk janë aq të ulëta, por kot, standardi i jetesës është rritur shumë. Unë doja të rritesha sepse kam kërkesa të prodhimit", thotë Hajdini.

Një sektor tjetër që vazhdimisht është në kërkim të punëtorëve

është gastronomia. Këtu mungojnë kamerierët,

banakierët, kuzhinierët dhe në veçanti mirëmbajtësit.

Florim Sermaxhaj, që menaxhon një biznes të gastronomisë në kryeqytet, thotë se thujse çdo muaj është i obliguar të shpallë konkurse për punëtorë. "Nevojë për punëtorë kemi sa të duash, por është bërë shumë problem të gjajmë. Si ta gesh një diamant, si ta gesh një punëtor - e njëjtë është bërë", tregon ai.

Sermaxhaj thotë se mosha e punëtorëve që punojnë në këtë sektorë është mes 18 dhe 27 vjeç. Për shumicën prej tyre që tashmë nuk punojnë për biznesin e tij, Sermaxhaj thotë se e kanë lënë punën pas një apo dy muajsh.

Në të shumtën e rasteve, shpjegon ai, ata kanë qenë duke pritur një termin për vizë pune jashtë vendit. Sermaxhaj thotë se kuzhinierët dhe mirëmbajtësit më së vështiri për t'i gjetur tani pasi, siç shpjegon ai, ka fare pak të tillë që janë të interesuar për të punuar. "Shumë, shumë problem është të gesh kuzhinier. Pastrues nuk gjen hiç se hiç. Ka një vit që kërkohet dikë, qoftë dy orë, të vijë për të pastruar, por nuk vjen askush", tregon Sermaxhaj.

Mungesa e kontratave të punës, orari i stërzgatur i punës, mohimi i pushimit vjetor si dhe shkelje të tjera të Ligjit të Punës nga bizneset janë, sipas disa qytetarëve, ndër arsyt kryesore që kanë ndikuar në rënien e interesimit të qytetarëve për të punuar në sektorin privat.

Në veçanti rol të rëndësishëm kanë luajtur edhe pagat e ulëta. I. K., një i ri nga qyteti i Kamenicës, thotë se ka punuar rreth pesë vjet në sektorin e gastronomisë në Prishtinë. Në shumicën e vendeve të punës



tregon se nuk ka pasur kontratë pune, nuk i është dhënë pushim vjetor, ka punuar me orar të stërzgatur dhe nuk i janë paguar kontributet.

Paga më e lartë që ka marrë ka qenë 300 euro, thotë ai.

Për shkak të pamundësisë që të fitojë të ardhura të mjaftueshme, ai ka vendosur para pak javësh që ta lërë punën dhe ia ka vendosur vetes si qëllim largimin nga Kosova. "Jam në pritje të terminit për vizë pune në Ambasadën gjermane. Po mbaj shpresë që e marr por që nuk mbërri të zë termin, atëherë më duhet t'i nostrifikoj diplomat dhe të ec nga këtu. Po, dua të shkoj në Gjermani", rrefën ai.

Ai thotë se nuk e ka menduar largimin nga Kosova para tre vjetësh kur kishte diplomuar për drejtësi, por pamundësia për të gjetur një punë të qëndrueshme ia ka ndryshuar mendjen.

Andi Sheqerolli, një i ri nga

qyteti i Pejës, ka punuar disa vjet në sektorin e gastronomisë, përfshirë kamerier dhe kuzhinier. Ai thotë se sektori privat nuk ofron mirëqenie për shumë punëtorë në Kosovë, sidomos pas shtrenjtimit të standardit të jetesës. "Sikur çdo i ri, normalisht se kemi pasur ide për t'u larguar nga shteti i Kosovës. Ka pasur shtrenjtimit të ushqimit, të energjisë elektrike. Pra, secili njeri mendon për një jetë më të mirë. Shumica mendojnë të largohen për një jetë më të mirë, për të arritur diçka më shumë. Mendoj se atje paguhen më shumë se në Kosovë", thotë ai.

Nga viti 2011 paga minimale në Kosovë është 130 euro për personat nën moshën 35 vjeç si dhe 170 për ata mbi 35 vjeç. Në muajin prill të këtij viti Qeveria e Kosovës miratoi projektligjin që i hap rrugës rritjes së pagës minimale në 264 euro bruto apo 250 neto.

Kryeministri Albin Kurti deklaroi më parë se nga ky vendim do të përfitojnë rreth 100 mijë punëtorë. Ky projektligj ende nuk është miratuar në Kuvendin e Kosovës.

Sipas Agjencisë së Kosovës për Punësim, në të gjithë territorin e Kosovës janë mbi 60 mijë punëkërkues aktivë.

Kjo agjenci ka një platformë në internet, në të cilën qytetarët mund të gjejnë një vend pune.

Jo të gjithë të papunët që janë të paraqitur fizikisht në zyrat e punësimit janë pjesë e kësaj platforme. Në fakt, janë shumë më pak, rreth 2 300.

Kamerierë, shitëse, punëtorë administrativë, edukatore, kujdestarë, punëtorë për sektorin e ndërtimitarisë dhe punëtorë në sektorin e përpunimit të metalit, aktualisht janë profesionet më të kërkues. Më së shumti vende të lira pune ka në qytetin e Dragashit, gjithsej 35.

Osmani për Asociacionin: Mbështes çdo iniciativë që s'ka kompetenca ekzekutive

PRISHTINË, 7 TETOR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, thotë se në takim me udhëheqësit e Francës dhe Gjermanisë, i është kërkuar të shtohet procesi i dialogut për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë.

Në një intervistë për Radion Evropa e Lirë në Pragë, Osmani thotë se Serbia do që "ta zvarrisë përgjithmonë këtë proces".

Në lidhje me Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe, për krijimin e të cilit dy vendet kanë një marrëveshje, Osmani thotë se mbështet "çdo iniciativë që nuk është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës". "Gjykata Kushtetuese ka treguar qartë që nuk mund të ketë Asociacion të komunave

që krijon një entitet njëetnik, nuk mund të ketë Asociacion të komunave me kompetenca ekzekutive dhe nuk mund të ketë Asociacion, i cili krijon një shtresë të re apo të ndërmjetme të qeverisjes ndërmjet komunave dhe nivelit qendror, sepse të gjitha këto do të ishin në kundërshtim me Kushtetutën e vendit. Prandaj, pak a shumë, e ka trasuar rrugën përpara. Gjykata lejon që të formohen asociacione pa kompetenca ekzekutive, që nuk janë njëetnike. Pra, janë bashkim komunash, që bashkohen për çështje të caktuara ose agjenda të caktuara dhe llobojnë për to tek institucionet qendrore", ka thënë ajo.

Sa i përket moszbatimit të vendimit të Gjykatës



Kushtetuese për tokën e Manastirit të Deçanit, Osmani thotë se ai vendim bazohet "në vendime diskriminuese të kohës së Millosheviqit" dhe

shton se Kosova duhet të jetë "e kujdesshme për precedentin që krijohet nga një vendim i tillë".

Osmani, po ashtu, flet për

grevën në sektorin e arsimit dhe thotë se mësimdhënësit që nuk kanë mbajtur orë gjatë shtatorit, duhet të paguhen nëse i kompensojnë ato.

Kushtet e këqija apo emigrimi, çfarë po i lë bizneset pa punëtorë?

PRISHTINË, 7 TETOR - Në dyert dhe dritaret e bizneseve në Kosovë janë bërë të shpeshta shpalljet nëpërmjet të cilave kërkohen punëtorë.

Dhjetëra biznese në kryeqytetin e Kosovës, Prishtinë, kanë të vendosura shpallje të tilla.

Shitës, punëtor arke, rrobaqepës, kuzhinier e kamerier janë profesionet që kërkohen më së shumti muajt e fundit.

Ekipi i Radios Evropa e Lirë ditët e fundit ka fotografuar dhjetëra shpallje të tilla në rrugët e kryeqytetit.

Zyrtarisht në nivel vendi, sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, papunësia kalon shifrat prej 17-përqindësh. Por, pavarësisht këtij niveli të lartë të papunësisë, bizneset po e kanë të vështirë të gjejnë punëtorë të rinj. Në konkurset e tyre pakkush paraqitet.

Bujar Hajdini është një biznesmen nga Prishtina që operon në sektorin e tekstilit.

Ai ka të punësuar rreth 30 punëtorë që kryesisht janë rrobaqepës. Aktualisht ka të hapur 20 vende të reja të punës. Përveç në rrjete sociale, ai ka vendosur edhe shpallje fizike me shpresën se dikush do të paraqitet. "Çfarë, nuk lajmërohet askush. Para 4-5 vitesh apo më shumë nuk ndalej telefoni kurrë", tregon Hajdini përvojën që ka me shpalljen e fundit.

Hajdini thotë se mungesa e punëtorëve, sidomos atyre të kualifikuar, ia ka pamundësuar zgjerimin e biznesit. "Të kualifikuarit shumica po dalin [jashtë vendit] edhe pse pagat nuk janë aq të ulëta, por kot, standardi i jetesës është rritur shumë. Unë doja të rritesha sepse kam kërkesa të prodhimit", thotë Hajdini.

Një sektor tjetër që vazhdimisht është në kërkim të punëtorëve

është gastronomia. Këtu mungojnë kamerierët,

banakierët, kuzhinierët dhe në veçanti mirëmbajtësit.

Florim Sermaxhaj, që menaxhon një biznes të gastronomisë në kryeqytet, thotë se thujse çdo muaj është i obliguar të shpallë konkurse për punëtorë. "Nevojë për punëtorë kemi sa të duash, por është bërë shumë problem të gjajmë. Si ta gesh një diamant, si ta gesh një punëtor - e njëjtë është bërë", tregon ai.

Sermaxhaj thotë se mosha e punëtorëve që punojnë në këtë sektorë është mes 18 dhe 27 vjeç. Për shumicën prej tyre që tashmë nuk punojnë për biznesin e tij, Sermaxhaj thotë se e kanë lënë punën pas një apo dy muajsh.

Në të shumtën e rasteve, shpjegon ai, ata kanë qenë duke pritur një termin për vizë pune jashtë vendit. Sermaxhaj thotë se kuzhinierët dhe mirëmbajtësit më së vështiri për t'i gjetur tani pasi, siç shpjegon ai, ka fare pak të tillë që janë të interesuar për të punuar. "Shumë, shumë problem është të gesh kuzhinier. Pastrues nuk gjen hiç se hiç. Ka një vit që kërkohet dikë, qoftë dy orë, të vijë për të pastruar, por nuk vjen askush", tregon Sermaxhaj.

Mungesa e kontratave të punës, orari i stërzgatur i punës, mohimi i pushimit vjetor si dhe shkelje të tjera të Ligjit të Punës nga bizneset janë, sipas disa qytetarëve, ndër arsyt kryesore që kanë ndikuar në rënien e interesimit të qytetarëve për të punuar në sektorin privat.

Në veçanti rol të rëndësishëm kanë luajtur edhe pagat e ulëta. I. K., një i ri nga qyteti i Kamenicës, thotë se ka punuar rreth pesë vjet në sektorin e gastronomisë në Prishtinë. Në shumicën e vendeve të punës



tregon se nuk ka pasur kontratë pune, nuk i është dhënë pushim vjetor, ka punuar me orar të stërzgatur dhe nuk i janë paguar kontributet.

Paga më e lartë që ka marrë ka qenë 300 euro, thotë ai.

Për shkak të pamundësisë që të fitojë të ardhura të mjaftueshme, ai ka vendosur para pak javësh që ta lërë punën dhe ia ka vendosur vetes si qëllim largimin nga Kosova. "Jam në pritje të terminit për vizë pune në Ambasadën gjermane. Po mbaj shpresë që e marr por që nuk mbërri të zë termin, atëherë më duhet t'i nostrifikoj diplomat dhe të ec nga këtu. Po, dua të shkoj në Gjermani", rrefën ai.

Ai thotë se nuk e ka menduar largimin nga Kosova para tre vjetësh kur kishte diplomuar për drejtësi, por pamundësia për të gjetur një punë të qëndrueshme ia ka ndryshuar mendjen.

Andi Sheqerolli, një i ri nga

qyteti i Pejës, ka punuar disa vjet në sektorin e gastronomisë, përfshirë kamerier dhe kuzhinier. Ai thotë se sektori privat nuk ofron mirëqenie për shumë punëtorë në Kosovë, sidomos pas shtrenjtimit të standardit të jetesës. "Sikur çdo i ri, normalisht se kemi pasur ide për t'u larguar nga shteti i Kosovës. Ka pasur shtrenjtimit të ushqimit, të energjisë elektrike. Pra, secili njeri mendon për një jetë më të mirë. Shumica mendojnë të largohen për një jetë më të mirë, për të arritur diçka më shumë. Mendoj se atje paguhen më shumë se në Kosovë", thotë ai.

Nga viti 2011 paga minimale në Kosovë është 130 euro për personat nën moshën 35 vjeç si dhe 170 për ata mbi 35 vjeç. Në muajin prill të këtij viti Qeveria e Kosovës miratoi projektligjin që i hap rrugës rritjes së pagës minimale në 264 euro bruto apo 250 neto.

Kryeministri Albin Kurti deklaroi më parë se nga ky vendim do të përfitojnë rreth 100 mijë punëtorë. Ky projektligj ende nuk është miratuar në Kuvendin e Kosovës.

Sipas Agjencisë së Kosovës për Punësim, në të gjithë territorin e Kosovës janë mbi 60 mijë punëkërkues aktivë.

Kjo agjenci ka një platformë në internet, në të cilën qytetarët mund të gjejnë një vend pune.

Jo të gjithë të papunët që janë të paraqitur fizikisht në zyrat e punësimit janë pjesë e kësaj platforme. Në fakt, janë shumë më pak, rreth 2 300.

Kamerierë, shitëse, punëtorë administrativë, edukatore, kujdestarë, punëtorë për sektorin e ndërtimitarisë dhe punëtorë në sektorin e përpunimit të metalit, aktualisht janë profesionet më të kërkues. Më së shumti vende të lira pune ka në qytetin e Dragashit, gjithsej 35.

Osmani për Asociacionin: Mbështes çdo iniciativë që s'ka kompetenca ekzekutive

PRISHTINË, 7 TETOR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, thotë se në takim me udhëheqësit e Francës dhe Gjermanisë, i është kërkuar të shtohet procesi i dialogut për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë.

Në një intervistë për Radion Evropa e Lirë në Pragë, Osmani thotë se Serbia do që "ta zvarrisë përgjithmonë këtë proces".

Në lidhje me Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe, për krijimin e të cilit dy vendet kanë një marrëveshje, Osmani thotë se mbështet "çdo iniciativë që nuk është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës". "Gjykata Kushtetuese ka treguar qartë që nuk mund të ketë Asociacion të komunave

që krijon një entitet njëetnik, nuk mund të ketë Asociacion të komunave me kompetenca ekzekutive dhe nuk mund të ketë Asociacion, i cili krijon një shtresë të re apo të ndërmjetme të qeverisjes ndërmjet komunave dhe nivelit qendror, sepse të gjitha këto do të ishin në kundërshtim me Kushtetutën e vendit. Prandaj, pak a shumë, e ka trasuar rrugën përpara. Gjykata lejon që të formohen asociacione pa kompetenca ekzekutive, që nuk janë njëetnike. Pra, janë bashkim komunash, që bashkohen për çështje të caktuara ose agjenda të caktuara dhe llobojnë për to tek institucionet qendrore", ka thënë ajo.

Sa i përket moszbatimit të vendimit të Gjykatës



Kushtetuese për tokën e Manastirit të Deçanit, Osmani thotë se ai vendim bazohet "në vendime diskriminuese të kohës së Millosheviqit" dhe

shton se Kosova duhet të jetë "e kujdesshme për precedentin që krijohet nga një vendim i tillë".

Osmani, po ashtu, flet për

grevën në sektorin e arsimit dhe thotë se mësimdhënësit që nuk kanë mbajtur orë gjatë shtatorit, duhet të paguhen nëse i kompensojnë ato.

Kërkohet promovimi i punës së grave në bujqësi

PRISHTINË, 7 TETOR - Në kuadër të projektit "Sired" është organizuar tryeza e rrumbullakët me temën "Roli i mediave në promovimin e agrobizneseve të grave në sektorin e përpunimit të frutave dhe perimeve". Drejtori i Shoqatës së Përpunimit të Pemëve dhe Perimeve, Hartim Gashi, ka thënë se qasja në medie e këtyre bizneseve është shumë e vështirë. "Gjatë gjithë kohës

kemi debate politike, rrallë ka debate për zhvillimin e bujqësisë. Eksportet e bujqësisë janë 150 milionë, bujqësia e Kosovës ka rritje signifikante prej vitit në vit. 2 500 janë të punësuar vetëm në sektorin tonë", ka theksuar ai. Në këtë tryezë u tha se hapësira është e kufizuar dhe është e domosdoshme që të promovohet puna e vështirë e grave në këtë sektor. Daniela Çoçaj nga "Ecokos

Women" kërkoi që t'u jepet hapësirë grave në zona rurale të cilat po punojnë me mund dhe sakrificë. "Me trajnime të ndryshme po mundohemi ta ngrehim vetëdijen e grave për punën dhe pronat. Ju nevojitet ndihma përmes donacioneve të ndryshme. Kemi shumë gra punëtore të cilat janë të gatshme të punojnë, por puna e tyre nuk po shihet askund", ka shtuar ajo.



KEDS-i: Mbi 30 mijë raste të vjedhjeve të energjisë elektrike në tre vjetët e fundit

PRISHTINË, 7 TETOR - Fenomeni i humbjeve të energjisë elektrike, që në praktikë klasifikohen si humbje teknike ose komerciale, është i barabartë me diferencën ndërmjet energjisë së prodhuar-bleurë dhe energjisë së shitur-konsumuar. Kështu thuhet në një njoftim të KEDS-it. "Humbjet e energjisë elektrike në rrjetin tonë shpërndarës janë minimizuar dukshëm falë planifikimit dhe mbarështimit adekuat të linjave elektrike dhe ndërmarrjes së hapave përkatës për shënjimin e saktë të këtyre humbjeve.

Që kur është privatizuar KEDS-i në vitin 2013, duke parë rrethanat ekzistuese të rrezikut nga humbjet komerciale-keqpërdorimet, Departamenti i Humbjeve të KEDS-it ndërmori vazhdimisht aksione në identifikimin e keqpërdoruesve të energjisë elektrike.

Falë përkushtimit të ekipeve të kontrollit të këtij departamenti, vetëm përgjatë periudhës 2019-2021 janë identifikuar mbi 30



mijë konsumatorë që janë kyçur ilegalisht në rrjetin e energjisë elektrike. Ndaj një numri të

konsiderueshëm të këtyre konsumatorëve tashmë janë ngritur kallëzime penale",

thuhet në njoftim. Edhe në periudhën e gjashtëmuorit të parë të këtij

viti janë regjistruar 3 281 raste të tilla. Megjithatë, ekipet e kontrollit të KEDS-it kanë shtuar praninë në terren me qëllim të zbutjes së mëtutjeshme të humbjeve të cilat ekipe po i realizojnë këto kontrole përmes përdorimit të pajisjeve të sofistikuar në dispozicion.

Kontrollet e nevojshme për minimizimin sa më të shumtë të humbjeve në rrjet japin mesazh të gjithë konsumatorët keqpërdorues se vjedhja e energjisë elektrike është dukuri e papranueshme dhe e dënueshme me ligjet e Republikës së Kosovës.

KEDS-i mbetet i përkushtuar që ta vazhdojë luftën ndaj vjedhjeve të energjisë elektrike dhe kërkon nga organet relevante dhe nga qytetarët të na bashkëngjiten në këtë betejë meqë së bashku mund të fitohet shumë më lehtë dhe më shpejt, duke bërë që konsumatorët të marrin shërbime më kualitative, më të lira dhe më të sigurta.

Evetar Zeqiri emërohet kryeshf ekzekutiv i KOSTT-it



PRISHTINË, 7 TETOR - Bordi i drejtorëve i KOSTT-it ka emëruar kryeshf ekzekutiv të KOSTT-it, Evetar Zeqiri. Ai ka theksuar se me përkushtim maksimal do ta shtyjë përpara misionin e KOSTT-it në funksion të sigurisë së furnizimit me energji elektrike për shoqërinë dhe ekonominë vendore, operim të sigurt dhe të besueshëm të Sistemit të Transmetimit dhe të integruar në tregun rajonal dhe evropian. "Jam i vendosur që përmes praktikave më të mira të

qeverisjes, KOSTT të jetë shembull i menaxhimit të ndërmarrjeve publike në Kosovë si dhe jam i përkushtuar që përmes planifikimit strategjik KOSTT të luaj rol të rëndësishëm në procesin e tranzicionit të drejtë të energjisë", tha ai.

Në njoftimin për medie thuhet se Evetar Zeqiri ka studiuar për Master në Administrim Publik (MPA) në Menaxhim Strategjik dhe Lidership, në Universitetin e Illinoisit Verior, në Shtetet e

Bashkuara të Amerikës, si bursist i programit për Lidership Transformues, program ky i bashkëfinancuar nga Qeveria Amerikane përmes USAID dhe Qeveria e Kosovës.

Ai më herët ka mbaruar edhe një master në Administrim të Biznesit (MBA) në Financa në Universitetin e Sheffieldit në Mbretëri të Bashkuar. Studimet themelore i ka përfunduar në Menaxhim dhe Informatikë në Universitetin e Prishtinës.

Kosova me borxhin më të ulët publik në rajon

PRISHTINË, 7 TETOR - Kosova është shteti me borxhin më të ulët publik nga vendet e rajonit në vitin 2021, kurse Mali i Zi ka borxhin më të thellë.

Borxhi publik është një nga treguesit bazë makroekonomik i cili tregon se sa është në borxh një shtet

i caktuar. Më konkretisht, borxhi publik paraqet një lloj të ardhurash publike që shteti realizon për të arritur qëllime paraprakisht të caktuara, pra mbulimin e shpenzimeve publike.

Ndërkohë, borxhi publik i Kosovës në fund të vitit 2021 ishte afër 1.7 miliard euro

ose 23.34 për qind, sipas të dhënave të Ministrisë së Financave të Kosovës.

Nëse krahasohet me vendet e tjera të rajonit, për sa i përket peshës në përqindje të borxhit publik në Prodhimin e Brendshëm Bruto (PBB), rezulton se ky vend ka borxhin publik më të ulët.



Lufta kundër lajmeve të rreme, pse duhet ndjekur modeli finlandez



Në Finlandë, lufta kundër lajmeve të rreme nisi që në vitin 1950. Në periudhën e pas Luftës së Dytë Botërore, përpara televizionit dhe internetit, ky vend kishte nisur zbatimin e një programit të edukimit mediatic në shkolla, për t'u mësuar nxënësve se si t'i qasen lajmeve të lexuara në gazeta apo të dëguara në radio.

Kjo traditë vazhdon edhe sot e kësaj dite. Në vitin 2002 Ministria e Arsimit, promovoi krijimin e klasave të veçanta për edukimin mediatic dhe sigurinë kibernetike, të cilat synojnë t'i mbrojnë lexuesit finlandezë nga keqinformimi. Sot në Finlandë, besimi tek media është 70 për qind, niveli i lartë në Evropë.

Ndërsa sipas agjencisë Reuters, në Itali norma është vetëm 35 për qind. Finlanda është pra një hap përpara në luftën kundër lajmeve të rreme, dhe ka shumë për t'i mësuar shteteve të tjera evropiane, që janë realisht të kërcënuara nga përhapja në rritje e lajmeve të tilla në mediatsociale.

"Kurrikula kombëtare bazë mbi

edukimin dhe kujdesin në fëmijërinë e hershme, arsimin parashkollor dhe arsimin bazë, përfshin fusha të ekspertizës të quajtura multi-edukim si dhe teknologjitë e informacionit dhe komunikimit"- thotë Laura Makela, konsulente në Ministrinë e Arsimit dhe Kulturës në Finlandë.

Sipas saj synimi është të edukohen qytetarët, që t'i trajtojnë me kujdes ato që lexojnë në internet. Në këtë mënyrë, njerëzit e të gjitha moshave kanë një shans më të mirë për të marrë pjesë në shoqëri dhe kulturë. Për më tepër, edukimi mediatic zhvillohet me një qasje të gjerë falë veprimeve edukative që promovojnë aftësitë e shkrim-leximit mediatic.

"Ministria mbështet zhvillimin e edukimit mediatic dhe pedagogjisë së edukimit mediatic në përmjet shpërndarjes së burimeve dhe zhvillimit të legjislacionit në këtë fushë"- deklaroi Makela gjatë një serie takimesh në kuadër të programit evropian "Erasmus+" me titull "Stop Fake

News".

Kjo sepse ata arrijnë të dallojnë lajmet e vërteta nga ato të rreme. Faktabaari është një shërbim finlandez i verifikimit të lajmeve dhe njohurive kompjuterike. Që nga viti 2014, kjo platformë ka kontribuar rregullisht në qarkullimin e informacionit të bazuar tek faktet.

Fushata është shoqëruar me projekte inovative dhe analiza të verifikimit të fakteve. Ky është një shërbim i disponueshëm për qytetarët finlandezë, në mënyrë që ata të kontrollojnë lajmet e lexuara në ueb dhe nëpërmjet mediave sociale. Afërsia e Ruisë i bën finlandezët edhe më vigjilentë.

"Ndërhyrja hibride ose lufta hibride, i referohet ndërhyrjes në punët e një shteti tjetër. Ajo kombinon operacionet e inteligjencës me mjetet tradicionale ushtarake dhe ekonomike të ndikimit dhe detyrimit"- thotë Petra Pitulainen-Ramsai, drejtuese e Faktabaari.

Shoqata të tjera në seli në Helsinkit si Mediapooli dhe

Kavi, por dhe televizioni kombëtar YleTV dhe gazeta Helsingin Sanomat,

organizojnë rregullisht kurse kur të gjithë qytetarët mund të mësohet të njohin se cilat lajme janë të rreme. "Ne nuk jemi këtu për t'i shërbyer qeverisë, por për të mirën e audiencës"- thotë Timo Huovinen i Yle TV.

Programi "News Class" i drejtohet nxënësve të shkollave të moshës 13-16 vjeç. Ata prodhojnë lajme dhe përvetësojnë shkrim-leximin mediatic. Nxënës nga e gjithë Finlanda marrin pjesë në kurset e organizuara periodikisht nga 19 stacionet televizive rajonale. Në këtë mënyrë, të gjithë nxënësit e shkollave finlandeze kanë dijeni mbi teknikat dhe metodologjitë e mësimdhënies së shkrim-leximit mediatic.


"Ndonjëherë një shoku im më tregon një video në TikTok, dhe unë i them se ajo nuk është një histori e vërtetë. Nuk e di nëse do të bëhem gazetar në të ardhmen, por kursi i edukimit mediatic është i dobishëm për të kuptuar se si funksionojnë realisht rrjetet sociale"- thotë

një nga nxënësit e shkollës fillore dhe të mesme në Hidenkiven, në periferi të Helsinkit.

Koncepti i edukimit mediatic në shkolla, përfshin aftësinë se si të vlerësoni median por edhe sesi të prodhoni përmbajtjen tuaj. Julia Alajarvi, drejtuese e shoqatës Kavi, e cila drejton Javën e Edukimit Mediatic në shkollat finlandeze thotë: "Keqinformimi dhe tema të tilla

si lajmet e rreme, kanë qenë prej vitesh në qendër të vëmendjes sonë. Tani kemi krijuar aftësi të së menduarit kritik tek shumica e qytetarëve. Kultura mediatic është shumë më tepër sesa lufta kundër keqinformimit. Që të kemi një shoqëri paqësore, ne duhet të forcojmë bindjen e qytetarëve tek demokracia dhe drejtësia".

Falë ligjeve largpamëse, Finlanda është pra një shembull për t'u ndjekur në luftën kundër dezinformimit, një aspekt ky gjithnjë e më i rëndësishëm në epokën dixhitale. /Wired - Bota.al



Kosova pëson humbje nga Ukraina

PRISHTINË, 7 TETOR - Kombëtarja e Kosovës në futsall ka pësuar humbjen e dytë në kuadër të kualifikimeve për Kampionatin Botëror 2024. Dardanët janë mundur nga Ukraina favorite, me rezultat

3:1. Ndeshja u zhvillua në qytetin leton, Salaspils, për shkak të luftës në Ukrainë. Kosova e nisi mirë ndeshjen dhe kaloi në epërsi qysh në minutën e dytë, kur realizoi Fejza Kastrati. Megjithatë,

ukrainasit barazuan shifrat në minutën e 15-të, me golin e Ihor Cherniavskyit, pas një gabimi në mbrojtje. Presioni i Ukrainës në pjesën e dytë ishte edhe më i madh dhe si rrjedhojë erdhën edhe dy gola.

Në minutën e 24-t shënoi Ihor Korsun, ndërsa tre minuta më pas për rezultatit përfundimtar shënoi Andri Melnyk. Ndeshjen e radhës Kosova e luan më 8 nëntor si vendase e Ukrainës.



Përkrahja institucionale shumë e rëndësishme në zhvillimin e basketbollit të Kosovës

PRISHTINË, 7 TETOR - Takimi i fundit i Sekretarit Gjeneral të FIBA Botës, Andreas Zagklis në Kosovë ishte me Ministrin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku. Ai në këtë takim së bashku me drejtuesit e lartë të FBK-së, kryetarin Arben Fetahu, sekretaren e Përgjithshme Elvira Dushku dhe anëtarin e Bordit, Valton Bilalli kanë kërkuar ndihmë për zhvillimin e basketbollit në Kosovë, gjegjësisht lojës 3x3 dhe masivizimit të këtij sporti, edukimin e trajnerëve, si dhe projekteve nga FBK. Gjatë takimit është konfirmuar bashkëpunimi i ngushtë mes FBK-së dhe MKRS-së, ku kjo e fundit e përkrah në projekte të ndryshme dhe do të jetë një krahë i fortë edhe për të ardhmen. Ministrin e Sportit i është dhuruar një dhuratë, si dhe një fanellë e Përfaqësueses së Kosovës me numër 1, ndërsa pas takimit është organizuar edhe një konferencë për

media. Ministri Çeku ka potencuar punën e mirë që po e bën FBK-ja me masivizimin e basketbollit dhe natyrisht që meritojnë përkrahje në zhvillimin e këtij sporti në vendin tonë. Ndërkohë, kryetari i FBK-së, Arben Fetahu ka shtuar se, FIBA, i ka dhënë përkrahje në nivel global, ndërsa "edhe pse jemi pranuar vonë, jemi shumë lartë me renditje me punën që kemi bërë, ndërsa ka shumë projekte, ku presim ndihmë edhe nga MKRS". Andreas Zagklis ka theksuar se basketbolli, gjegjësisht FBK-ja ka nevojë për ndihmë institucionale për zhvillimin e këtij sporti në Kosovë dhe duhet shikuar mënyra se si të përkrahen këto projekte, që janë shumë të rëndësishme dhe jetike për zhvillimin e basketbollit në Kosovë. Zagklis është takuar me kryetarin e Komunës së Prishtinës, Përparim Ramën. Gjatë takimit



është diskutuar për ndihmën që mundet të japë Komuna e Prishtinës për FBK-në, gjegjësisht infrastrukturën sportive. Në takim është biseduar se, vendi ynë ka nevojë për një palestër të madhe sportive për organizimin e ngjarjeve madhore evropiane, si dhe ato

ndihmëse, ku do të mund të aktivizohen gjeneratat e reja dhe fëmijët. FBK-ja ka organizuar disa Kampionate Evropiane deri më tani dhe është shquar për organizimin e tyre, duke qenë shembull për shumë vende të tjera. Në takim është konfirmuar bashkëpunimi i ngushtë mes

FBK-së dhe Komunës së Prishtinës dhe FIBA-s. Në fund të takimit, Andreas Zagklis i ka dhuruar Ramës fanellën me numër një të Përfaqësueses së Kosovës dhe një dhuratë për të parin e të kryeqytetit të Kosovës, që i dhuroi Hyjneshën në Fron, që simbolizon qytetin e Prishtinës.

Distria e fiton medaljen e bronzë në Kampionatin Botëror



Prishtinë, 7 tetor - Distria Krasniqi ka arritur ta fitojë medaljen e bronzë në Kampionatin Botëror të xhudos që po mbahet në Tashkent të Uzbekistanit. Krasniqi në kategorinë deri në 52 kilogramë zuri vendin

e tretë, pasi në luftë për medaljen e bronzë e mundi xhudisten nga Izraeli, Gefen Primo. Dueli shkoi në "Golden Score", teksa izraelitja mori tri penalizime. Në raundin e parë, Distria kaloi pa luftë,

kurse në të dytin triumfoi me IPPON për 30 sekonda. Çerekfinalen, ajo e arriti pasi mundi me IPPON xhudisten italiane, Giuffrida Odetta, e cila mori tri penalizime që i kushtuan me eliminim. Në çerekfinale me sukses

triumfoi me një waza-ari ndaj xhudistes nga Mongolia, Khorloodoi Bishrelt. Por, në gjysmëfinale, Distria u mund në "Golden Score" nga xhudistja britanike, Chelsie Giles.

Bashkimi i bashkohet Penzës në finale

PEJË, 7 TETOR - Bashkimi mundi Prishtinën me rezultat 78:65 (23:13, 14:18, 25:13, 16:21), duke u kualifikuar në finale të Superkupës së femrave. Skuadra prizrenase e nisi ndeshjen më mirë, ku në fillim krijoi epërsi prej nëntë pikësh, 16:9, dhe gjatë gjithë çerekun të

parë ishte në epërsi, që e fitoi 23:13. Prishtinaset këndellen në periudhën e dytë, ku afruan rezultatit në 25:23, megjithatë prizrenaset kishin epërsi të lehtë dhe shkuan në pushim me rezultat 37:31. Por, në pjesën e dytë, përkatësisht periodën e tretë, ku krijuan

epërsinë më të lartë në 22 pikë, 62:40, kurse shifrat në semafor pas 30 minutash ishin 62:44. Prishtina u mundua në dhjetë minutat e fundit të rikthehet, megjithatë, nuk ia arriti qëllimit dhe Bashkimi triumfoi 78:65. Te Bashkimi u dalluan Arbnore Përquku me 27 pikë e

gjashtë asistime, Taliyah Hopkins me 16 pikë, nëntë kërcime e pesë asistime, kurse te Prishtina u dallua Sarah Mgbeike me 19 pikë e 14 kërcime. Finalja e madhe mes Penzës dhe Bashkimit zhvillohet të dielën nga ora 20:00.





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit / Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije / Ministry of Education, Science, Technology and Innovation

Prishtinë

Në bazë të nenit 8, 67 dhe 68 të Ligjit nr. 06/L- 114 për Zyrtarët Publik, nenit 20 të Ligjit nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe të Udhëzimit administrativ të MASHTI nr. 151/2020 për Detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe të zëvendës drejtorit të institucionit publik edukativo - arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm, rishpall:

KONKURS

PËR PLOTËSIMIN E VENDIT TË PUNËS

Titulli i vendit të punës : **Drejtor në shkollën speciale “Shpresa” në Shtime**

Lloji i vendit të punës: Me afat të caktuar, me orar të plotë

Numri i pozitave: Një (1) pozitë

Kategoria funksionale: Nivel drejtues

Koeficienti: 7.8

Kohëzgjatja e emërimit: Me afat të caktuar (4 vite)

Qëllimi i vendit të punës: Udhëheqja, menaxhimi dhe mbikëqyrja e institucionit edukativo-arsimor

DETYRAT KRYESORE TË PUNËS :

- Menaxhimi dhe administrimi i përgjithshëm i institucionit;
- Hartimi i planit vjetor të punës dhe planit zhvillimor të institucionit arsimor dhe raportet vjetore të punës;
- Përdorimi efikas dhe efektiv i sistemit për menaxhimin e informatave në arsim dhe respektimi e kodeve të këtij sistemi, procedurave të sigurimeve dhe afateve të përcaktuara për përditësimin e të dhënave të nevojshme gjatë vitit shkollor;
- Detyrat e caktuara për zgjedhjen e mësimdhënësve, vlerësimin, disiplinën në institucionin edukativo-arsimor dhe çështje tjera që kanë të bëjnë me mësimdhënësit dhe punëtorët tjerë në arsim;
- Mbështetja dhe mbikëqyrja e zbatimit të kurrikulës;
- Mbështetja dhe mbikëqyrja e punës së aktiveve dhe bashkëpunëtorëve profesional të institucionit edukativo-arsimor si dhe mekanizmave tjerë të institucionit arsimor që kanë rol në vlerësimin e performancës dhe menaxhimin e cilësisë së punës së institucionit;
- Bashkëpunimi me këshillin drejtues të institucionit edukativo- arsimor (KDSH),
- Këshillin e Prindërve, Këshillin e Arsimitarëve, Këshillin e Nxënësve dhe komunitetin e institucionit edukativo- arsimor;
- Raporton së paku dy herë në vit para KDSH;
- Siguron ambient të sigurt dhe përkrahës për fëmijët/nxënësit duke përfshirë edhe caktimin dhe aplikimin e masave disiplinore ndaj nxënësve, sipas legjislacionit në fuqi;
- Ruajtja e dokumenteve dhe të dhënave, siç parashihet nga komuna apo Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI);
- Çështjet e tjera që rregullohen përmes Ligjit për arsim parauniversitar, akteve nënligjore të miratuara nga MASHTI dhe obligimet që dalin nga rregulloret e QB.

Kërkesat e përgjithshme për pranimin e zyrtarëve publik:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotëroj njërin nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas ligjit.

Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve:

- Të kenë të kryer arsimin universitar të nivelit: Master për udhëheqje administrim ose menaxhim në arsim (kualifikim prej 300 ECTS, së paku 5 vite të shkollimit universitar);
- Master arsimor (kualifikimin prej 300 ECTS/5 vite të shkollimit universitar);
- Katërvjeçar (kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar)
- Bachelor katërvjeçar (kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar);
- Të kenë licencë të rregullt të mësimdhënësit sipas udhëzimit për licencim të mësimdhënësit;
- Të kenë përfunduar me sukses një program të akredituar të kualifikimit profesional për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, të bazuar në standardet e praktikës profesionale për drejtor të shkollave në Kosovë, të aprovuar nga MASHTI sipas rekomandimeve të KSHLM;
- Të ketë përvojë pune në procesin edukativo- arsimor sipas udhëzimeve të përcaktuara në katalogun e punës;

- Pesë (4) vite përvojë pune në procesin edukativo-arsimor për kandidatët për drejtor në arsimin e mesëm të ulët.

Kandidati duhet të posedoj dhe të dëshmoj dokumentet në vijim:

- Diplomat e fakultetit të kryer për nivelin përkatës të kualifikimit;
- Certifikatat për kryerjen me sukses të programit të trajnimit për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, të bazuar në standardet e praktikës profesionale për drejtor të shkollave në Kosovë.
- Kandidati/ja që ka të përfunduar programin universitar Master për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, (në mungesë të certifikatës së trajnimit për udhëheqje në arsim kandidati/ja ofron dëshminë e diplomës Master për udhëheqje;
- Kopjen e dokumentit të identitetit (ID);
- Certifikatën shëndetësore të lëshuar në gjashtë muajt e fundit nga një institucion i licencuar shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore;
- Dëshminë se kandidati nuk është nën hetime dhe dëshminë se nuk ka qenë i/e dënuar për krim, dhunë ose vepra të padenja që përfshijnë fëmijët;
- Dëshmi të përvojës së punës në procesin edukativo- arsimor;
- Deklaratën në betim që vërteton se në tri vitet e fundit kandidati/ja nuk ka qenë në asnjë funksion udhëheqës në strukturat e partive politike.
- Portfolio profesionale me dëshmi sipas udhëzimeve në shtojcën/formularin H të UA, nr. 151/2020 për Detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe të zëvendës drejtorit të institucionit publik edukativo - arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm.
- Dokumentacioni i aplikimit përcaktohet më lartë, dorëzohet në kopje fizike në zyrën dhe afatin e përcaktuar në konkurs publik.
- Kandidati/ja në një konkurs publik ka të drejtë të aplikoj në një e më shumë shkolla. Në raste të tilla përgatit dokumentacion të ndarë për secilën shkollë ku aplikon.
- Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës, duhet të kenë të nostrifikuar diplomat nga MASHTI.

Afati dhe mënyra e aplikimit

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë, aplikacionet dorëzohen nga data 08.10.2022 deri me 22.10.2022 Formulari i aplikimit i plotësuar (merret në uebfaqe të MASHTI (<https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/05/aplikacioni.pdf>).

Dokumentet duhet të jenë kopje sepse ato nuk kthehen, ndërsa origjinali do të kërkohet me rastin e intervistimit
Informata të saktë dhe të vërteta konsiderohen vetëm ato informata që dëshmohen me dokumente (jo ato që janë të deklaruara pa dëshmi)

Kandidatët, dokumentet duhet ti dorëzojnë në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e pakompletuara nuk shqyrtohen (refuzohen).

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “Lumnori” SH.P.K. me pronar Lumnor Hoxha, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810129248 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Lumnori” D.O.O. sa vllasnikum Lumnor Hoxha, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810129248 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the “Lumnori” L.L.C. with owner Lumnor Hoxha, has come to the decision to quit its business: 810129248 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Inovacionit- Ministarstvo Obrazovanja Nauke
Tehnologije i Inovacije- Ministry of Education, Science and Technology*

Priština

Na osnovu člana 8, 67 i 68 Zakona br. 06 / L-114 O javnim službenicima, član 20 Zakona br. 04 / I-032 o Preduniverzitetskom obrazovanju u Republici Kosovo i Administrativno uputstvo MONTI-a br. 151/2020 o dužnostima i odgovornostima direktora i zamenika direktora Javnih edukativno-obrazovnih i osposobljavajućih institucija u Republici Kosovo, Procedure izbora i imenovanja, Završetak ugovora i Privremeno imenovanje, obnavlja:

K O N K U R S

ZA POPUNJAVANJE SLOBODNOG RADNOG MESTA

Naziv radnog mesta: **Direktor u specijalnoj školi "Shpresa" u Štimlje**

Vrsta radnog mesta: Na neodređeno, puno radno vreme

Broj pozicija: Jedna (1)

Funkcionalna kategorija: Upravni nivo

Koeficijent 7,8

Period imenovanja: NA određeno vreme (4 godine)

Cilj radnog mesta: Rukovođenje, menadžiranje i nadzor edukativno-obrazovne institucije

GLAVNI RADNI ZADACI

- Opšte menadžiranje i upravljanje institucije;
- Izrada godišnjeg plana rada i razvojnog plana obrazovne institucije i godišnjih izveštaja o radu;
- Efikasno i efektivno korišćenje sistema za menadžiranje informacijama u obrazovanju i poštovanje kodeksa ovog sistema, procedura osiguranja i rokova za ažuriranje potrebnih podataka u toku školske godine;
- Zadaci određeni za izbor nastavnika, ocenjivanje, disciplina u Edukativno-obrazovnoj instituciji i druga pitanja u vezi sa nastavnicima i drugim radnicima u obrazovanju;
- Podrška i nadgledanje sprovođenje kurikuluma;
- Podržavanje i nadzor nad radom aktiva i stručnih saradnika u edukativno-obrazovnoj instituciji, kao i drugih mehanizama obrazovne institucije koji imaju ulogu u vrednovanju performanse i menadžiranje kvalitet rada institucije;
- Saraduje sa upravnim savetom edukativno-obrazovne institucije (ŠUO),
- Savet roditelja, Savet nastavnika, Savet učenika i zajednica edukativno-obrazovne institucije;
- Izveštava najmanje dva puta godišnje ispred ŠUO;
- Obezbeđuje bezbedno i podsticajno okruženje za decu / učenike, uključujući izricanje i primena disciplinskih mera prema učenicima, u skladu sa važećim zakonima;
- Očuvanje dokumenata i podataka, kao što je predviđeno od strane opštine ili Ministarstvo obrazovanja , nauke, tehnologije i inovacije (MONI);
- Ostala pitanja regulisana zakonom o preduniverzitetskom obrazovanju, podzakonskim aktima odobreno od strane MONTI-a i obaveze koje proizilaze iz pravilnika RC.

Opšti zahtevi za prijem javnih službenika

- Da su državljani Republike Kosovo;
- Imaju punu sposobnost da deluje;
- Da govori jedna od službenih jezika, u skladu sa Zakonom o jezicima;
- Da je sposoban za zdravstvenom pogledu sposoban da izvrši odgovarajući zadatak;
- Da nije pravosnažnom presudom kažnjavan za izvršeno krivično delo;
- Da nema disciplinsku meru koja je na snazi za razrešenje sa funkcije javnog službenika, razrešenog po zakonu.

Uslovi i kriterijumi za izbor kandidata:

- Imaju ima završeno fakultetsko obrazovanje nivo: Master za rukovođenje administriranje ili menadžiranje u obrazovanju (kvalifikaciju od 300 ECTS najmanje 5 godina univerzitetskog obrazovanja);
- Master obrazovni (kvalifikacija od 300 ECTS / 5 godina univerzitetskog školovanja);
- Četiri godine (kvalifikacija 240 ECTS/4 godine univerzitetskog školovanja);
- Bachelor četverogodišnji (kvalifikacija 240 ECTS / 4 godine univerzitetskog obrazovanja)
- Da ima redovnu licencu za nastavnika u skladu sa uputstvom za licenciranje nastavnika;
- Da je uspešno završio akreditovani program profesionalne kvalifikacije za rukovođenje, administraciju ili menadžiranje u obrazovanju, zasnovan na standardima profesionalne prakse za direktore škola na Kosovu, odobrene od strane MONTI prema preporuka DSLN;
- Da ima radno iskustvo u edukativno-obrazovnom procesu prema smernicama navedenim u radnom katalogu

- Pet (4) godine radnog iskustva u edukativno-obrazovnom procesu za kandidata direktor u niže srednje obrazovanje;

kandidat mora da poseduje i da dokaže sledeća dokumenta:

- Diploma o završenom fakultetu za odgovarajući nivo kvalifikacije;
- Sertifikat o uspešnom završetku program treninga za rukovođenje, administriranje ili menadžiranje u obrazovanju, zasnovano na standardima profesionalne prakse za direktore škola na Kosovu,
- Kandidat/kinja koji ima završen univerzitetski program Master za rukovođenje, administriranje ili menadžiranje u obrazovanju, (u nedostatku sertifikata o završenoj obuci za rukovođenje u obrazovanju kandidat/kinja, dostavlja kao dokaz diplomu Master rukovođenja.
- Kopija identifikacionog dokumenta (ID);
- Zdravstveni karton izdat poslednja šest meseca od strane određene licencirane
- zdravstvene institucije kojim dokazuje njegovo/njeno zdravstveno stanje;
- Dokaz da kandidat nije pod istragom i dokaz da nije osuđivan/a za zločine, nasilje ili nedostojna dela kojima su obuhvaćena deca;
- Dokaz o radnom iskustvu u edukativno-obrazovnom procesu;
- Izjava pod zakletvom kojom se potvrđuje da u poslednje tri godine kandidat nije bio ni na jednom rukovodećem mestu u strukturama političkih partija.
- Profesionalni portfolio sa dokazima prema uputstvima u prilogu / obrascu H, br. 151/2020 o dužnostima i odgovornostima direktora i zamenika direktora Javne edukativno-obrazovne i osposobljavajuće institucije u Republici Kosovo, Procedurama za izbor i imenovanje, Završetak ugovora i privremenom imenovanju.
- Dokumentacija za prijavljivanje je definisana gore, dostavlja se u štampanoj formi kancelariji u roku utvrđenom na javnom konkursu.
- Kandidat/kinja na javnom konkursu ima pravo da se aplicira u jednoj ili više škola. U takvim slučajevima priprema posebno odvojeno dokumentaciju za svaku školu u koju aplicira.
- Osobe koje su diplomirale van Kosova moraju da izvrše nostrifikaciju diplome u MONTI.

Rok i način apliciranja

Konkurs ostaje otvoren 15 dana, aplikacije se podnose od 08.10.2022 do 22.10.2022. Popunjeni obrazac za apliciranje (dobija se na web stranici MONTI-a (<https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/05/aplikacioni.pdf>).

Dokumenti moraju biti kopije jer se ne vraćaju, dok će original biti potreban tokom intervju Tačne i istinite informacije smatraju se samo one informacije koje su dokazane dokumentima (a ne oni koji su deklarirani bez dokaza)

Kandidati moraju dostaviti dokumenta Ministarstvu obrazovanja, nauke, tehnologije i inovacije. Aplikacije dostavljene nakon navedenog roka neće biti prihvaćene, dok nepotpune aplikacije neće se razmatrati (biće odbijene).

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Dafina Kelmendi shpall të pavlefshme dokumentet e shkollës së mesme "Gjin Gazulli Prishtinë.
- Muharem Eger shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.
- Alejna Zurnagji shpall të pavlefshme dëftesat e kl VI- IX shfmu "Mati Logoreci" Prizren.
- Hamro Rama shpall te pavlefshme dëftesat shmlt "11 Marsi " Prizren.
- Aulon Krasniqi shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.
- Muharem Rama shpall te pavlefshme dëftesat shmlt "11 Marsi " Prizren.
- Valton Muqaj shpall të pavlefshme diplomën dhe certifikaten shmlt "11 Marsi" Prizren.
- Zylfi Gutaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu " Luigj Gurakuqi " Nashec.
- Agim Braha shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.
- Valtin Muqaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shmu " Dëshmorët e Kabashit " Korishe.
- ShkelzenRaçi shpall të pavlefshme dëftesat nga viti i I,II,III,IV si dhe Diplomën e shkollës së mesme "Gjin Gazulli" Prishtinë.
- Visar Kryeziu shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu " Xhevat Berisha " Prizren.
- Qendrim Gashi shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.
- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- Qendrim Gashi shpall te pavlefshme dëftesat shm " Skender Laurasi " Suhareke.



ROYAL CROWN
RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1905